

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 2705 rep.

Nr. 485 kol.

14



AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ORANGE SPORT SHPK

Sot me date 19.03.2007, para meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht Z. Gjergj SKENDAJ, shtetas shqiptar, lindur me 29.08.1981, ne Tirane, i biri i Marselit dhe Veres, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, kati 10, Tirane, mbajtes i pasaportes nr. Z10114111, person madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili themelon sot nepermjet ketij akti nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe dispozitave te parashikuara me poshte.

I.

Kriilimi

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ORANGE SPORT Shpk." (me poshte e quajtur "Shoqeria"), themelohet ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".


II.

Objekti i shoqerise

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj kryerjen e çdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe ne veçanti:

1. Ndermjetesimin per blerjen dhe/ose shitjen e te drejtave te transmetimit radioteleviziv te veprimtarive sportive, kulturore dhe çdo programi radioteleviziv, ngjarje apo shfaqje te lidhura me keto veprimtari;
2. Agjentin ne lidhje me blerjen dhe/ose shitjen e te drejtave te transmetimit radioteleviziv te veprimtarive sportive, kulturore dhe çdo programi, ngjarje apo shfaqje te lidhura me keto veprimtari;
3. Komisionerin dhe broker per blerjen dhe/ose shitjen e te drejtave radiotelevizive, mbi transmetimin e ngjarjeve dhe aktiviteve sportive, kulturore dhe çdo ngjarje apo shfaqje te lidhur me to;
4. Agjensi reklamash dhe promovimesh.
5. Sherbime mbeshtetese te aktivitetit te agensise, ndermjetesimit, komisionerit te blerjes/shitjes se te drejtave te transmetimit radioteleviziv dhe te drejtave te publikimit ne media te shkruar, duke perfshire por pa u limituar ne gazeta, revista, billboards, te shfaqjeve sportive dhe kulturore;
6. Ndermjetesime dhe pjesemarrje ne shoqeri te tjera;
7. Import dhe/ose eksport te mallrave dhe sherbimeve te ndryshme;

8. Ne pergjithesi, kryerjen e çdo veprimtarie tregtare, industriale apo transaksioni me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme qe lidhen me objektin e lartpermendur te shoqerise.



III.
Sella

Sella e Shoqerise do te jete ne adresen:

- Rruga Dervish Hima nr. 1, AdaTower, Tirane, Shqiperi.
Shoqeria mund te hape dege dhe zyra dhe/ose te kryeje aktivitet ne vende te tjera, brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

IV.
Kohezgjatia

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

V.
Ortaku Themelues

Ortak themelues eshte:

- Z. Gjergj SKENDAJ, shtetas shqiptar, lindur me 29.08.1981, ne Tirane, i biri i Marselit dhe Veres, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, kati 10, Tirane, mbajtes i pasaportes nr. Z10114111.

VI.
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise do te jete 100.000 Leke (njqindmije) i ndare ne 100 (njqind) pjese me vlere nga 1.000 (njemije) Leke secila.

I gjithe kapitali themeltar do te nenshkruhet dhe do te shlyhet ne para nga Ortaku.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne çdo moment sipas kushteve te parashikuara nga ligji shqiptar.

Pergjegjesia e ortakut per humbjet e Shoqerise shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

VII.
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga Z. Gjergj SKENDAJ, shtetas shqiptar, lindur me 29.08.1981, ne Tirane, i biri i Marselit dhe Veres, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, kati 10, Tirane, mbajtes i pasaportes nr. Z10114111. Administratori i Shoqerise do te qendroje ne detyre deri ne momentin e shkarkimit te tij.

Veprimet e administrimit te Shoqerise perpara te treteve do te konsiderohen te vlefshme nese jane ndermarre dhe nenshkruar nga Administratori i saj. Administratori i Shoqerise ka te gjitha kompetencat e nevojshme per te kryer çdo veprim te zakonshem dhe te jashtezakonshem dhe akt ne kuader te aktivitetit te Shoqerise.

VIII.

Pergjegjësia Personale

Pasuria e ortakut, administratoreve, punonjesve dhe/ose agjenteve te Shoqerise, eshte e perjashtuar nga çfaredo lloj detyrimi qe rendon mbi Shoqerine.


IX.

Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti kalendarik.


Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.


Nenshkruar nga Ortaku sot me date 19.03.2007.


Gjergj Skendaj

Une Noteri i Dhomes se Notereve Tirane, ia lexoj me ze te larte tekstin e ketij akti Z. Gjergj Skendaj, ortak i shoqerise **ORANGE SPORT** Shpk, per identitetin dhe per cilesine e te cilit mora dijeni nga dokumentet e tij personale, i cili njihet me permbajtjen e ketij dokumenti dhe pasi e gjen permbajtjen e ketij Akti Themelimi ne perputhje me vullnetin e tij te plote e te lire, e nenshkruan ate rregullisht ne pranine time dhe une Noteri vertetoj kete akt sipas ligjit, sot me date 19.03.2007.

NOTER


NOTER
TIRANE



**STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ORANGE SPORT SHPK**

**NENI 1
EMERTIMI**

Emertimi i shoqerise eshte "ORANGE SPORT Shpk.", me poshte e quajtur "Shoqeria"



**NENI 2
PERSONALITETI JURIDIK**

Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar nepermjet vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane.

**NENI 3
SELIA**

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: "Rruga Dervish Hima, nr. 1, AdaTower, Tirane, Shqiperi". Shoqeria mund te hape dege, zyra dhe/ose te kryeje aktivitet ne vende te tjera si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, sipas vendimit te Shoqerise.

**NENI 4
KAPITALI**

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 Leke (njeqindmije) i ndare ne 100 (njeqind) pjese me vlere nga 1.000 (njemije) Leke secila.

I gjithe kapitali themeltar eshte nenshkruar dhe shlyer ne para nga Ortaku.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne çdo moment sipas kushteve te parashikuara nga ligji shqiptar.

Pergjegjesia e ortakut per detyrimet e Shoqerise shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

**NENI 5
ZMADHIMI I KAPITALIT**

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim te jashtezakonshem te Ortakut. Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me derdhje ne para ose me kontribute ne natyre. Ne çdo rast keto kontribute duhet te shoqerohen me nje çertifikate per depozitimimin e

tyre ose nje raport vleresimi teknik te kryer nga nje ekspert i vleresimit te kontributeve ne natyre. Eksperti emerohet me vendim te gjykates sipas kerkeses se bere nga administratori.



NENI 6 ZVOGELIMI I KAPITALIT

Zvogelimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim te jashtezakonshem te Ortakut, me propozim te administratorit, ne rastin kur shoqeria mund te pesoje humbje te tilla qe ta bejne te domosdoshem kete zvogelim.

Kapitali themeltar nuk mund te jete me i vogel se vlera minimale e caktuar me ligj, ne rast te kundert shoqeria detyrohet te ndryshoje formen juridike ose te priset.

NENI 7 TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Transferimi teresisht ose pjeserisht i pjeseve te kapitalit themeltar behet gjithmone duke u vertetuar me nje akt noterial.

NENI 8 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj kryerjen e çdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe ne veçanti:

1. Ndermjetesimin per blerjen dhe/ose shitjen e te drejtave te transmetimit radioteleviziv te veprimtarive sportive, kulturore dhe çdo programi radioteleviziv, ngjarje apo shfaqje te lidhura me keto veprimtari;
2. Agjentin ne lidhje me blerjen dhe/ose shitjen e te drejtave te transmetimit radioteleviziv te veprimtarive sportive, kulturore dhe çdo programi, ngjarje apo shfaqje te lidhura me keto veprimtari;
3. Komisionerin dhe broker per blerjen dhe/ose shitjen e te drejtave radiotelevizive, mbi transmetimin e ngjarjeve dhe aktiviteteteve sportive, kulturore dhe çdo ngjarje apo shfaqje te lidhur me to;
4. Agjensi reklamash dhe promovimesh.
5. Sherbime mbeshtetese te aktivitetit te agensise, ndermjetesimit, komisionerit te blerjes/shitjes se te drejtave te transmetimit radioteleviziv dhe te drejtave te publikimit ne media te shkruar, duke perfshire por pa u limituar ne gazeta, revista, billboards, te shfaqjeve sportive dhe kulturore;
6. Ndermjetesime dhe pjesemarrje ne shoqeri te tjera.
7. Import dhe/ose eksport te mallrave dhe sherbimeve te ndryshme;
8. Ne pergjithesi, kryerjen e çdo veprimtarie tregtare, industriale apo transakcioni me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme qe lidhen me objektin e lartpermendur te shoqerise.

NENI 9
KOHEZGJATJA

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pa kufizuar.

NENI 10
ORTAKU

Ortak themelues është:

- Z. Gjergj SKENDAJ, shtetas shqiptar, lindur më 29.08.1981, në Tiranë, i biri i Marselit dhe Veres, banues në adresën: Rruga Dervish Hima nr. 1, kati 10, Tiranë, mbajtes i pasaportës nr. Z10114111.

Ortaku në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në këto, vendime për ndryshimin e këtij Statuti, pjesëmarrjen në shoqëri të tjera, zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, transferimin teresisht apo pjesërisht të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, emerimin dhe shkarkimin e Administratorit(eve), emerimin e ekspertit(eve) kontabel të autorizuar, miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë dhe të çdo raporti financiar brenda gjashtë muajve nga mbyllja e vitit financiar të Shoqërisë, shpërndarjen e Shoqërisë, likuidimin e Shoqërisë, emerimin e likuidatorit(eve).

NENI 11
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

1. Kompetencat

Pasuria, aktiviteti dhe biznesi i Shoqërisë do të drejtohet dhe administrohet nga një Administrator i vetëm, i cili mund të ushtrojë çdo kompetencë të zakonshme e të jashtëzakonshme e mund të kryejë çdo veprim të ligjshëm në emër të Shoqërisë me përjashtim të atyre që ligji apo ky Statut ia rezervon Ortakut.

Veprimet e administrimit të shoqërisë përpara të treta do të konsiderohen të vlefshme nëse janë nënshkruar dhe nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë.

Administratori ka të drejtë t'u delegojë me prokurë një pjesë apo të gjitha kompetencat e tij personave të treta të caktuar prej tij.

2. Emerimi dhe Kohezigjatia e Mandatit

Administratori do të emerohet me vendim të Ortakut dhe do të qëndrojë në këto detyra derisa të emerohet zëvendësuesi ose zëvendësuesja e tij ose e saj, ose deri në momentin e dorëheqjes, shkarkimit ose vdekjes.


3. Shkarkimi

Administratori mund të shkarkohet në çdo moment për arsye të drejte, me vendim të Ortakut.



NENI 12
EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Eksperti(et) kontabel te autorizuar do te emerohet(n) me vendim te Ortakut çdo rast kur nje gje e tille kerkohet nga ligji shqiptar ose kur shihet e arsyeshme nga Ortaket.



NENI 13
VITI USHTRIMOR

Viti ushtrimor i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

NENI 14
REZERVA

Nga fitimi i realizuar gjate vitit perkates financiar, Shoqeria do te menjanoje nje shume jo me te vogel se 1/20 e fitimit, e cila do te kaloje per llogari te fondit rezerve te domosdoshem te Shoqerise.

Menjanimi i pjeses se fitimit nuk eshte i detyrueshem kur Fondi Rezerve arrin nje vlere te barabarte me 1/10 e Kapitalit Themeltar te Shoqerise

NENI 15
SHPERNDARJA

Shperndarja e Shoqerise si dhe emerimi i likuidatorit(eve) behet ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 16
BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptar.

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te aplikohen normat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

Çdo konflikt qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij Statuti, si dhe çdo konflikt qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve do te jete objekt i zgjidhjes nepermjet vendimit te Gjykatave shqiptare.

NENI 17
NDRYSHIMET

Ky Statut mund te ndryshohet, fshikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose i teri dhe te zevendesohet me nje statut tjetri me vendim te Ortakut.

Nenshkruar nga Ortaku sot me date 19.03.2007.



Gjergj Skendaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 2706 rep.

Nr. 486 kol. 12

VERTETIM

Une Noteri i Dhomes se Notereve Tirane, ia lexoj me ze te larte tekstin e ketij akti Z. Gjergj SKENDAJ, shtetas shqiptar, lindur me 29.08.1981, ne Tirane, i biri i Marselit dhe Veres, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, kati 10, Tirane, mbajtes i pasaportes nr. Z10114111, i cili njihet me permbajtjen e ketij dokumenti dhe pasi e gjen permbajtjen e tij ne perputhje me vullnetin e tij te plote dhe te lire, e nenshkruan rregullisht ne pranine time dhe une Noteri vertetoj kete akt sipas ligjit, sot me date 19.03.2007.

NOTER

